



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 62, date 20.08.2018


P Ë R

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E Z. JAKO DANI, PJETËR, ERVIN, FRANC PJETRA, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 20.08.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja "dh", 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile", të ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtime të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr. 85, datë 26.12.2017 "Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2018", Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Jako Dani**, (3 anëtarë familje) në vlerën prej **60.000 lekë** (gjashtëdhjetë mijë), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Pjetër Pjetra** (2 anëtarë familje) në vlerën prej **40.000 lekë** (dyzet mijë), për dëmtimin e banesës nga zjarri.



3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Ervin Pjetra** (3 anëtarë familje) në vlerën prej **60.000 lekë** (gjashtëdhjetë mijë), për dëmtimin e banesës nga zjarri.
4. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Franc Pjetra** (3 anëtarë familje) në vlerën prej **60.000 lekë** (gjashtëdhjetë mijë), për dëmtimin e banesës nga zjarri.
5. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile në programin 10910 parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 të miratuar me VKB nr.85, datë 26.12.2017, në programin P13, F1 O1 A2. (transferime për individë).
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër.
7. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 254.905 lekë (dyqind e pesëdhjetë e katërmijë e nëntëqind e pesë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 97.800 lekë (nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) sipas preventivava të komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjet z. **Jako Dani**, në total **352.705 lekë** (treqind e pesëdhjetë e dymijë e shtatëqind e pesë).
8. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 2.173.710 lekë (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e tremijë e shtatëqind e dhjetë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 621.520 lekë (gjashtëqind e njëzet e një mijë e pesëqind e njëzet) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjet z. **Pjeter Pjetra**, në total **2.795.230 lekë** (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e e dyqind e tridhjetë).
9. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjen e z. Jako Dani, e Pjeter Pjetra, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
10. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 220.000 lekë (dyqind e njëzet mijë).
11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
12. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Miratuar në datën 20.08.2018
Shpallur në datën 22.08.2018

Sekretar i keshillit

Suel Hadri



KRYETAR



Xhemil BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1078/1 prot.

Shkodër, më 06.09.2018

LËNDA: Lidhur me vendimin nr. 62, datë 20.08.2018 të Këshillit Bashkiak Shkodër.

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin", neni 8, gërma a, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 29, neni 54, gërma dh, neni 55, pika 3, neni 64, gërma c, të ligjit nr. 8756, dt. 26.03.2001 "Per emergjencat civile", i ndryshuar, të VKM nr. 329, dt. 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, të Udhëzimit të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, dt. 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", të VKM nr. 965, dt. 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave", shkresave të MPB nr. 7007 prot., dt. 20.10.2016, nr. 806 prot., dt. 08.02.2017, nr. 3950 prot., dt. 21.06.2017, shqyrtoi VKB Shkodër nr. 62, datë 20.08.2018 "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, sipas dokumentacionit tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e z. Jako Dani, si dhe Pjeter, Ervin, Franc Pjetra, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedimin me burim financimi fondin e emergjencave civile në programin 10910, funksioni P13, F1 O1 A2, miratuar me VKB Shkodër nr. 85, dt. 26.12.2017 "Buxheti i vitit 2018".

Me respekt,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË, SHKRESA, KERKESA
NR. 14583 DATE 10. 09. 2018
BERGUAR
LËNDA :

PREFEKTI

Çesk MILLIJA

POSHTA E TITULLARIT:

Adresa: Rruga "28 Nëntori" Shkodër, Telefon/Faks 00355 2224 2705, e-mail: prefektur@shkodër@yahoo.com

